



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 29.09.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 11:18.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Brikena Ukperaj.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*

2. Luan Dibra, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Vjollca Kola, Këshilltare Ligjore pranë Njesisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

5. Paola Ndroqi, përfaqësuese nga Universiteti "Epoka".

6 Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë", i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar kolegë!

Meqenëse është krijuar kuorumi i nevojshëm, mbledhjen e sotshme të datës 29.09.2022, ora 11:00, e deklaroj të hapur.

Sipas rendit të ditës së njoftuar me postë elektronike, sot kemi shqyrtimin e projektvendimit "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë", relacioni i përgatitur përkatës nga Komisioni Disiplinor dhe do të relatohet përpara Këshillit, relatore znj. Marçela Shehu.

Për më tej, fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {...} prot., datë 22.09.2022 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të

ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “g” dhe “gj” e këtij ligji.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...}, të masës disiplinore “Vërejtje publike”, të parashikuar nga neni 107 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, e cila ka lidhje me statusin profesional të magjistratit, z. {...}, në referim të nenit 63 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit. Relator do të caktohet njëri nga anëtarët e Komisionit Disiplinor.

Menjëherë pas caktimit me short të relatorit, nga Këshilli duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin e relatorit, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Nga sa u parashtrua më sipër, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 115/2016, në nenin 138 e vijues të ligjit nr. 96/2016 dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 02/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Do të ftoja për hedhjen e shortit.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Atëherë, vazhdojmë me procedurën mbi hedhjen e shortit.

Procedura e shortit:

Në vazon e qelqit hidhen shiritat e letrës me emrat e tre anëtarëve të Komisionit Disiplinor: znj. Marçela Shehu, z. Ilir Rusi dhe z. Ridvan Hado.

Procedura e përzgjedhjes:

Relator i përzgjedhur për procedimin disiplinor nr. 2/2022, rezulton z. Ridvan Hado.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Atëherë, pas hedhjes së shortit, relator për çështjen përkatëse u caktua anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, njëkohësisht edhe anëtar i Komisionit Disiplinor z. Ridvan Hado.

Për më tej, vazhdojmë me miratimin e projektvendimit përkatës me shtesën që caktuam edhe relatorin përkatës. Kështu që tek pika 1 do të jetë “1. Caktimi i anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado...”. Kalojmë në votimin e projekt-aktit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Dakord.

Zoti Kurushi ka një koment mbi qëndrimin e tij në raport me vendimmarrjen.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar.

Vota ime është kundër vetëm në aspektin që meqenëse kam përshtypjen që është çështja e parë që hidhet short për kolegun tonë. Unë do të preferoja që kolegu në këtë pjesë të përjashtohej nga shorti dhe ata që kishin më tepër përvojë ta merrnin këtë çështje paraprakisht. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, me shumicë votash miratohet projektvendimi i cili kthehet në vendim.

Vendim për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2022, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, pasi shqyrtoi materialet e çështjes, relacionin e përgatitur, pas shortit të hedhur, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2022, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

2. Një kopje e këtij vendimi t'i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Me shqyrtimin e kësaj çështjeje, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Faleminderit!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor